



Biografi e shkurtër

Albana Jegeni, Këshilltare Ekonomike

Albana Jegeni diplomohet në vitin 1995 në degën “Administrim Biznes” në Fakultetin Ekonomik, pranë Universitetit të Tiranës. Në vitin 2007 përfundon studimet Master në Administrim Publik (MPA) në Fakultetin e Ekonomisë, pranë Universitetit të Tiranës.

22 vite eksperiencë në sektorin e planifikimit dhe menaxhimit të investimeve të huaja në veprat e infrastrukturës. Specialiste/menaxhere finance në projekte të ndryshme të financuara nga Banka Botërore, BERZH, BEI, Fondi i Opekut, Fondi Kuvajtjan, Programi Phare.

Studime pasuniversitare për vlerësim pasurie si dhe një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit në fushën e menaxhimit të kontratave të punimeve dhe konsulencës, planifikimit dhe teknikave të financimit. Zotëron gjuhën angleze dhe italiane.

Aktualisht, mban pozicionin e Këshilltarit Ekonomik pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.